



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 783/2 Prot.

Tiranë, më 29.5 2017

**REKOMANDIM**

Nr. 16 datë 29.5 2017

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të Ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, neneve 77-112 të Ligjit nr.44/2015 "*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*", si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit Universiteti i Sporteve të Tiranës.

**VËREJSE:**

Në zbatim të Urdhrit Nr.138 datë 09.05.2017 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetim administrativ pranë kontrolluesit, Universiteti i Sporteve të Tiranës me objekt kontrolli:

- Zbatimimi i Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" i ndryshuar dhe akteve të miratuara nga Komisioneri, në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit të kontrolluesit Universiteti i Sporteve të Tiranës.

Grupi i kontrollit, gjatë kryerjes së veprimeve procedurale, u asistua nga përfaqësuesit e kontrolluesit, të cilët ishin njohur me Urdhrit Nr.138, datë 09.05.2017 të Komisionerit.

Kontrolluesi Universiteti i Sporteve të Tiranës, është institucion i edukimit publik dhe aktualisht është i organizuar në tre fakultete: Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes, Fakulteti i Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit dhe Instituti i Kërkimit Shkencor.

Kontrolluesi Universiteti i Sporteve të Tiranës, përpunon të dhëna personale kryesisht për subjektet e dhënave "*punëmarrës*" dhe "*studentë*". Përpunimi i të dhënave kryhet në mënyrë manuale (nëpërmjet dokumentacionit në formatin letër) si dhe në mënyrë elektronike nëpërmjet sistemeve të teknologjisë së informacionit të tilla si sistemi i video-vëzhgimit (CCTV), portali zyrtar i institucionit, pajisje kompjuterike etj.

Gjatë hetimit administrativ të ushtruar në vend, është konstatuar:

1. Kontrolluesi ka "*Njoftuar*" Zyrën e Komisionerit në lidhje me përpunimin e të dhënave personale por nuk ka kryer përditësimin e këtij njoftimi për rubrikën 10.1 dhe nuk ka njoftuar mbi prezencën e sistemit të video-vëzhgimit (CCTV). Konstatimi përbën shkelje administrative të nenit 21 dhe 22 të ligjit - "*1. Çdo kontrollues duhet të njoftojë Komisionerin për përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës. Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i gjendjes së njoftimit të përpunimit, sipas nenit 22 të këtij ligji, të njoftuar më parë.*".

2. Kontrolluesi disponon rregullore për *"Përpunimin dhe mbrojtjen e të dhënave personale"*.
3. Kontrolluesi ka nënshkruar *"Deklaratë Konfidencialiteti"* me punëmarrësit të cilët kanë akses në mbledhjen, përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave personale.
4. Kontrolluesi mbikëqyr ambientet e brendshme dhe të jashtme nëpërmjet sistemit të video-vëzhgimit (CCTV), por në ambientet e tij nuk kishte tabela informuese dhe nuk disponon rregullore për funksionimin e këtij sistemi. Koha e ruajtjes së të dhënave imazhe-video është 10 ditë. Gjatë kontrollit përfaqësuesi i kontrolluesit paraqiti formatin e tabelës informuese mbi prezencën e sistemit të video-vëzhgimit (CCTV), në përputhje me formatin standard të miratuar në Udhëzimin Nr.46 të Komisionerit. Konstatimi përbën shkelje administrative të nenit 18 të ligjit dhe Udhëzimit Nr.46 të Komisionerit, e konkretisht nenit 6, pika 1, germa "e" e tij - *"1) Çdo subjekt publik dhe privat i cili vendos masat shtesë të sigurisë, ka për detyrë:*  
*e) të mbajë dhe administrojë të dokumentuar veprimet e kryera gjatë përpunimit të të dhënave personale me mjetet shtesë të sigurisë"*.
5. Kontrolluesi nuk ka publikuar në portalin zyrtar <http://www.ust.edu.al> *"Politikat e Privatësisë"*. Informacioni i publikuar në *"Politikës së Privatësisë"*, duhet të ketë për qëllim informimin e subjekteve të të dhënave që vizitojnë këtë portal, mbi mënyrat e përpunimit të të dhënave, masat e sigurisë, ruajtjes së konfidencialitetit, të drejtat e subjekteve të të dhënave dhe detyrimet e kontrolluesit në kuadër të mbrojtjes së privatësisë. Konstatimi përbën shkelje administrative të nenit 18 të ligjit - *"1. Kontrolluesi, kur mbledh të dhëna personale, duhet të informojë subjektin e të dhënave për fushën dhe qëllimin, për të cilin do të përpunohen të dhënat personale, për personin që do t'i përpunojë të dhënat, për mënyrën e përpunimit..."*.
6. Në ambientet e serverëve, kryente detyrën një punonjës i cili nuk ishte pjesë e departamentit të teknologjisë dhe informacionit, kur hyrja në dhomat e serverëve ndalohet për personat e paautorizuar. Konstatimi përbën shkelje administrative të nenit 27 të ligjit, pika 2, germa "ç" - *"2. Kontrolluesi merr këto masa të veçanta sigurie:*  
*ç) ndalon hyrjen në mjediset e kontrolluesit ose të përpunuesit të të dhënave të personave të paautorizuar"*.

Zyra e Komisionerit, mban në konsideratë faktin që kontrolluesi ka qenë në bashkëpunim serioz me grupin e hetimit administrativ gjatë ushtrimit të kontrollit.

Sa më sipër:

Në zbatim të nenit 32/1 të Ligjit Nr. 9887 datë 10.03.2008 *"Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale"* i ndryshuar,

#### **REKOMANDOJ :**

1. Në zbatim të nenit 21 dhe 22 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 *"Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale"* i ndryshuar, kontrolluesi Universiteti i Sporteve të Tiranës, të realizojë në vazhdimësi përditësimin e Formularit të Njoftimit.
2. Në zbatim të nenit 27 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 *"Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale"* i ndryshuar, dhe Udhëzimit Nr.46 datë 05.03.2010 të Komisionerit, kontrolluesi Universiteti i Sporteve të Tiranës, të hartojë rregullore për funksionimin e sistemit të vëzhgimit (CCTV), dhe të vendosë në ambientet e tij tabelat e informimit.

3. Në zbatim të nenit 18 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, kontrolluesi Universiteti i Sporteve të Tiranës të hartojë dhe publikojë në portalin zyrtar të tij, rubrikën "Politikat e Privatësisë".
4. Në zbatim të nenit 27 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, kontrolluesi Universiteti i Sporteve të Tiranës, të marrë masat për mos lejimin e personave të paautorizuar në ambientet e serverëve.
5. Kontrolluesi Universiteti i Sporteve të Tiranës, të realizojë plotësimet e detyrimeve të parashikuara në pikat 2, 3, 4 dhe 5 të këtij Rekomandim, brenda afatit 30 ditor nga momenti i marrjes dijeni.
6. Në rast mos përmbushje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 30/2 dhe 39 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjorbë për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më datë 29/5/2017

**BESNIK DERYISHI**  
  
**KOMISIONERI**